



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1213/ 7 prot.

Datë 31.07.2023

V E N D I M
Nr. 697/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik **“Ervin Luzi” pf** në procedurën e prokurimit **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”**, me Nr. REF-62412-03-15-2023 me objekt: “Blerje tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2023”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejës.

Ankimues: Operatorit Ekonomik “Ervin Luzi”, Person Fizik.
Adresa: Lagjja Katund i Ri, rruga “Ali Pashë Gucia”, Godina nr. 5, Yrshek, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vau i Dejës
Adresa: Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16-03-2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-62412-03-15-2023 me objekt: “Blerje tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2023”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejës.

II.2. Në datë 26-04-2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton, se në datën 23.05.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë

të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. “Ervin Luzi” PF	858900 lekë	skualifikuar
2. “Bledi Bilali ”Pf	1199000 lekë	kualifikuar
3. “ADD Print” SHPK	1338000 lekë	kualifikuar
4. “Infosoft Office” SHPK	1357643 lekë	kualifikuar
5. “Marketing & Distribution” SHPK	1359021 lekë	kualifikuar
6. “TIM” SHPK	1372500 lekë	skualifikuar

II.4. Më datë 23.05.2023 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave dhe nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar operatorin ekonomik “Ervin Luzi” Pf SHPK për arsyen e skualifikimit të ofertës së tij si më poshtë vijon:

“Mostrat e paraqitura nga ana juaj ne ditën e hapjes së ofertave, janë paraqitur me etikete të ngjitur, ndryshe nga se është kerkuar nga AK, Gjithashtu nuk janë original, dukshem nga ambalazhimi I tyre.

II.5. Në datën 24.05.2023 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.6. Në datën 29.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1213 prot., e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” Pf, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1213/2 prot., datë 30.05.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi” Pf nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr.3381/2 prot., datë 08.06.2023 , protokolluar me tonën nr. 1213/3 prot., datë 14.06.2023, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës me nr. prot 3381 datë 08.06.2023, së operatorit ekonomik ankimues, ku ka vendosur refuzimin e ankesës së tij.

II.9 Me shkresën nr. 1213/4 datë 10.07.2023, KPP i dërgon shkresë Autoritetit kontraktor dhe për dijeni dhe operatorit ekonomik Ervin Luzi, me objekt “Gjithashtu, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorit

ekonomik ankimues, autoriteti juaj duhet të dorëzojë pranë institucionit tonë, mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” PF si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese.”

II.10 Nëpërmjet shkresës me nr.4321/1 prot., datë 14.07.2023 , protokolluar me tonën nr. 1213/5 prot., datë 14.07.2023, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin mbi shkresën e dërguar nga KPP, me lëndë “Kthim-përgjigje” shkresës me nr. 1213/4 datë 10.07.2023, ku citohet “Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 1213/4 Prot.date 10.07.2023 protokolluar në Bashkinë Vau Dejës me nr. 4321 Prot datë 13.07.2023 sqarojmë se bashkëngjitur do të gjeni mostrat e paraqitura nga Operatori Ekonomik "Ervin Luzi Person Fizik për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2023 me nr. REF 62412-03-15-2023”.

II.101 Me shkresën nr.1213/6 prot., datë 24.07.2023, me qëllim gjykimin e drejtë dhe objektiv të çështjes, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Ervin Luzi” Pf për zhvillimin e një seance dëgjimore, me datë 27.07.2023, në mjediset e KKP.

II.11. Në datë 27.07.2023 u zhvillua në mjediset e KPP-së seanca dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Ervin Luzi” Pf, në mungesë të përfaqësuesit të autoritetit kontraktor Bashkia Vau i Dejës. Seanca dëgjimore u regjistrua audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.12. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në formë shkresore dhe as në sistem elektronik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Ervin Luzi” Pf nga procedura e prokurimit me arsyen se: “Mostrat e paraqitura nga ana juaj ne ditën e hapjes se ofertave, janë paraqitur me etikete te ngjitur, ndryshe nga se është kërkuar nga AK, Gjithashtu nuk janë original, dukshem nga ambalazhimi i tyre” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të modifikuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentet e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për disa nga mallrat objekt prokurimi, të përcaktuara me nr. Rendor: 2,6,14,15,16,23 sipas listës së publikuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën nr. 6.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e Bashkisë Vau Dejës (Sektori i Prokurimeve)

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër të kryerje shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.
- OE duhet të deklarojë se tonerat të jenë origjinal, jo kompatibel, jo te ricikluar, jo te manifaturuar, duhet të deklarojë se deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara.
- OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike dhe ne pullen e sigurise.
- Per te vertetuar origjinalitetin e tonerave do te behet kontrolli nepermjet barkodit ne internet.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

III.1.2. Në shtojcën e publikuar nga AK autoriteti ka modifikuar kriteret me poshte:

Ishte :

- OE duhet të deklarojë se tonerat të jenë origjinal, jo kompatibel, jo te ricikluar, jo te manifaturuar, duhet të deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kerkuara

Behet:

- OE duhet të deklarojë se tonerat të jenë origjinal, jo kompatibel, jo te ricikluar, jo te manifaturuar ose ekuivalent,duhet të deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kerkuara

Ishte:

OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike dhe ne pullen e sigurisë.

Bëhet:

OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike.

III.1.3. Në kthimin e përgjigjes në lidhje me këto pretendime autoriteti kontraktor ka argumentuar;

Si personi përgjegjes për shqyrtimin e ankesës pasi verifikova mostrat e paraqitura nga PF Ervin

Luzi sqaroi se:

Mostrat nuk plotesojnë kërkesat e vendosura nga AK, konkretisht :

Tonerat sjellë moster, nuk kanë emrin e prodhuesit të tonerit, aq me tepër, ky emer prodhuesi nuk është as në paketimin e jashtëm dhe as në pjesën plastike.

Me tonera ekuivalente, nënkuptohen tonera prodhuar edhe nga kompani të tjera përveç prodhuesit të pajisjes, por gjithnjë këto kompani emri dhe marka e tyre) duhet të jenë evidentuar qartë në paketimin e tonerit.

Gjithashtu, mostrat paraqitur, nuk kanë një barcod me ane të të cilit të behen verifikimet në internet.

Barcodet që ndodhen në disa nga mostrat, nuk japin asnjë informacion për produktin dhe as cila është kompania prodhuese.

AK, ka vendosur kërkesa, të cilat janë pranuar nga OF dhe me këto kushte kanë vendosur të marrin pjesë. AK, ka detyrimin që të vendosë në kushte barazie dhe jo diskriminimi të gjithë OE pjesëmarrës, OE, janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, sikurse është e rëndësishme për AK, që malli i ofruar, të jetë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, duke refuzuar si të papranueshme ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente.

Mostrat e dorëzuara, nuk kanë përputhshmeri me specifikimet teknike të kërkuara. Konkretisht, në paketim mungojnë edhe të dhëna të tonerave, përcaktuar në specifikimet teknike. Konkretisht, nuk ka të përcaktuar në kuti kapacitetin e kopjeve që printohet me tonerat e ofruar, specifikim ky i përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Referuar LPP, në një procedurë prokurimi, operatori ekonomik, si pale e interesuar, është i detyruar të përgatisë ofertën në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, do të refuzohen si të

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në pikën 6 të nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.6. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioni konstatoi, se referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues si për pretendimet e këtij të fundit, si për arsyen e skualifikimit, gjykoi të arsyeshme zhvillimin e një seance dëgjimore. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit”*. Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së tjetër, dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve për të kryer një ballafaqim lidhur me mostrat e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor nga ankimuesi.

III.1.7 Në datën 27.07.2023 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt seanca dëgjimore/audio midis operatorit ekonomik ankimues, dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik.

-Në seancën dëgjimore/audio mori pjesë perfaqesuesi i Operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi” Pf.

Në Ankesën e depozituar pranë KPP, operatori ekonomik ngre pretendime për faktin se tonerat e dorëzuara në cilsi dhe mostres nuk janë OEM, por janë bojra ekuivalente, duke paraqitur oferten me bojra ekuivalente.

Në seancën dëgjimore audio, Komisioni i drejtoi pyetje Operatorit ekonomik në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, dhe ju drejtua me pyetjen:

A janë mostrat e dorëzuara nga ana juaj, dhe mund të bëni verifikimin perkates...?

Autoriteti Kontraktor u shpreh se:

Po.

KPP shprehet se :

Konfirmohet nga ana e perfaqesuesit te operatorit ekonomik se mostrat e dorëzuara nga ana e tyre per procedure e prokurimi objekt-ankimi.

Komisioni i drejtoi pyetje perfaqesuesit te Operatorit ekonomik:

Konkretisht mund te bejme nje verifikim te mostrave te dorezuara, dhe cilat jane kundershkrimet e juaja mbi pretendimet e Ak se mostrat e dorezura, nuk jane origjinale dhe se etiketat jane te ngjitura jo nga prodhuesi apo distributori i autorizuar?

Pergjigja e operatorit ekonomik:

Dhe vete Ak kerkon qe mostrat te jene Ekuivalente, ne fillim kerkuan qe te ishin origjinale, dhe me pas kane nxjerre nje shtojce, dhe sipas kesaj shtojce kerkon qe te jene dhe ekuivalente, dhe ne kur kemi dorezuar kemi shkruar qe mostrat jane ekuivalente, ashtu siç e kerkojne ne dispozitat ligjore, siç eshte ligji per prokurimet dhe vendimi i APP.

KPP ju drejtua:

Mund te bejme nje verifikim te mostrave dhe te jepni argumentin tuaj pse jane ekuivalente dhe ne lidhje me pretendimet me etiketen e ngjitur.

Dhe te bejme verifikimin:

Jane kerkuar 6 mostra me nr rendor ne 2 boje per fotokopje Xerox 3025, 106R03048, Twin Pack 2x1500 3000 kopje, cila eshte mostra e dorezuar nga ana juaj per kete procedure prokurimi, dorezohet mostra, i cilit prodhues ekivalent esht ekuivalent mund ta indentifikoni?

Pergjigja e Oe

Eshte Xerox,

Pyetje drejtuar nga KPP

Pra ju deklaroni se mostra me nr. 2 eshte e prodhuesit Xerox apo eshte per fotokopje Xerox

Pergjigja e OE

Eshte per fotokopje Xerox, nuk eshte se mar shume vesh pasi jam juriste.

Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua per cdo moster te administruar prane KPP, me te njejtat pyetje si me siper, por pa nje pergjigje konkrete, ne lidhje me evidentimin e Ekuivalences per artikujt e kerkuar, dhe a evindetohet prodhuesi.

Ne lidhje me pretendimet e autoritetit kontraktor, se ne mostrat e dorezuara nga ana juaj, etiketat jane te ngjituara dhe nuk jane te prodhuesit. Ne mostren me nr. rendor 2, e cila eshte nje kuti e bardhe pa pershkrime te tjera prodhuesi dhe ka vetem nje etikete, etiketa eshte leshuar nga prodhuesi apo eshte nje etikete e vendosur,

Pergjigja e Oe;

Eshte etikete e vendosur vete.

KPP iu drejtua perfaqesuesit te OE-se :

Nga ana juaj pretendohet se Ekuivalenca mund te vertetohet vetem nepermjet testimi te mostrave.

Pergjigja e OE

Po sic thote APP ne rekomnadime, mjafton qe nje toner te jete i pershtatshem per printerin, dhe eshte ekuivalente.

KPP drejtohet:

Ne rast te testimi te mostrave, subjekti juaj ekonomik, merr persiper kostot e testimi te mostrave perfshire bojrat per testimin e mostrave, letren per testimin e mostrave, sipas sasise se kopjeve te kerkuar nga ana e AK dhe te gjithe kostot e tjera, pra Ju deklaruar ne seance se ekuivalenca mund te provohet nermjet testimi te mostres ne printerin.

Ne rast se KPP do te konstatoje se nuk ka nje menyre tjeter per te verifikuar ekuivalencen e mostrave sipas deklarimeve qe ju bete ne seance, qe mund te testohen mostrat, merr persiper kostot operatori ekonomik per testimin e mostrave prane AK ose prane Komisionit te Prokurimit Publik per keto printera dhe per keto bojera duke perfshire dhe venien ne dispozicion te kostos se fleteve, amortizimit te pajisjeve dhe me pas do verifikohen te gjitha kostot e mundshme.

Pergjigja e OE:

Kjo eshte nje procedure jo me fitim te madh, por qe te behen te gjithe keto shpenzime me nga 3000 kopje, 15000 dhe ne dispozicion kaq leter eshte jo shume e logjikshme. Ne jemi per te vendosur ne printer, por jane shum shpenzime.

Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të mostrave të kërkuara nga ana e AK më sipër, operatori ekonomik ka dorëzuar mostrat të cilat u administruan pranë KPP. Nisur nga pretendimet në seancën dëgjimore/audio e operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi” Pf për përmbushjen e kriterit, se mostrat e dorëzuara janë Ekuivalente, KPP konstaton, se referuar seancës dëgjimore dhe pyetjeve drejtuar operatorit ekonomik ankimues, në asnjë moment operatori ekonomik, pasi cituam mostrat me radhë dhe iu drejtua, se si vertetohet se artikujt e dorëzuar janë ekuivalent, operatori ekonomik nuk ju përgjigj për asnjë nga artikujt fizik, se ato mund të evidentoheshin ekuivalent nga marka/brandi prodhuesi apo kodi, ndaj në seancën dëgjimore u propozua nga ana e operatorit ekonomik që të bëhej një testim në printera. Në seancën dëgjimore audio të mbajtur në vijim të asaj që u diskutua në lidhje me faktin e testimi të këtyre tonerave në ambientet pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me përfaqësues të operatorit ekonomik dhe anëtarëve të KPP, përgjigja e përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues pas propozimit të testimi të tonerave, ishte se nuk ishin dakort të mbulonin të gjitha kostot e këtij testi. KPP gjykon, se nga sa më sipër, nga parashtrimet e palës në seancë dëgjimore, dhe faktit se nuk do të testohen këto mostra, KPP gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ Ervin Luzi” Pf nuk qëndrojnë.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” Pf, nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 117 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë

ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranoje ankesën e operatorit ekonomik “Ervin Luzi ” Pf në procedurën e prokurimit “**Procedurë e hapur e thjeshtuar**”, me Nr. REF-62412-03-15-2023 me objekt: “Blerje tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2023”, me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau i Dejës.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik ankimes “Ervin Luzi ” Pf.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri